



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 393/3 prot.

Tiranë, më 13.04.2018

V E N D I M

Nr.26, datë 13.04.2018

**PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 223,
DATË 06/11/2017, NË NJËSINË E VETËQEVERISJES VENDORE BASHKIA
POLIÇAN**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës,

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues nr. 223, datë 06/11/2017, të Komisionerit,

VENDOSA:

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 223, datë 06/11/2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Poliçan dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.
2. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:

1. Zamira Mujali Inspektor, në Drejtorinë e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ

2. Helga Peti Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

3. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt dhe grumbullimin e të dhënave që materializojnë zbatimin e vendimit, në datat **16.04.2018 - 18.04.2018**.
4. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës do të vijojë me përpunimin e të dhënave. Akti i konstatimit, procesverbali i mbajtur në subjekt, si dhe dokumentacioni i administruar, lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionerit, do t'i paraqiten për të vijuar procesin Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, brenda datës **19.04.2018**. Relacioni duhet të përpilohet deri në datën **30.04.2018**. Më pas do t'i paraqitet për miratim Komisionerit, dhe më tej, do të hartohet vendimi për përmbylljen e procesit, brenda **3** ditëve.
5. Vendimi i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e procedimit administrativ (*verifikimit*) do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur, Bashkisë Poliçan dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
6. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
7. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që të sigurojë mbështetjen e grupit të verifikimit me logjistikë, për vijimin normal të procesit, në përputhje me programin e miratuar.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

Konceptoi: *H. Peti*
Miratoi: *E. Hebibasi*